

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Fituesi i paracaktuar", a po kthehet KQZ pas AKSHI-t në "hotspotin" e ri të skandaleve me tenderët?
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/fituesi-i-paracaktuar-a-po-kthehet-kqz-pas-akshi-t-ne-hot-spotin-e-ri--i106547
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:21:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:03:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	42718269bbce0e79b8b3eb0927bdfc65b8f055b2b33827efb4ca40f9fe4339fe
TEKSTI	2fd3fb6f82723a24a32d9f20644fcb55047b9764ead9abd940c2d13f871d63d1
PAMJA	e03f1dfb851d96b7f1cf3fe33e83271d15275e3b695a2c87f815f826266ab8be

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b8fb4be90d8b56f274982b2320b8d3278b10074dba0c30ed8348a5458ae67166
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b8fb4be90d8b56f274982b2320b8d3278b10074dba0c30ed8348a5458ae67166>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

ri të skandaleve

për shërbimet që lidhen me administrimin

vrasje me paramendim

basikepunim me homolog&eu...

kundër Ukrainës

së Veriut ndodhen aktualisht

e lartë të Hamasit

kreun e krahut të armatosur


Iranit. Do bisedojmë,

se Shtetet Bashkuara kanë ofruar Iranit

AKTUALITET

“Fituesi i paracaktuar”, a po kthehet KQZ pas AKSHI-t në “hotspotin” e ri të skandaleve me tenderët?

Piranjat Përditësimi i fundit 29 Shtator 2026, 10:03



Me afrimin e zgjedhjeve lokale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po shton prokurimet për shërbimet që lidhen me administrimin e zgjedhjeve, nga magazinimi i materialeve dhe arkivimi digjital i rezultateve, deri te përdorimi i inteligjencës artificiale.

Por tenderi i radhës i institucionit të drejtuar nga Ilirjan Celibashi është bërë shkak për ankesa dhe akuza të forta në Komisionin e Prokurimit Publik. Kompanitë pretendojnë se KQZ ka kufizuar garën dhe paracaktuar fituesin përmes kriterëve specifike.

Bëhet fjalë për procedurën me fond limit 17.76 milionë lekë pa TVSH, për implementimin e një sistemi inteligjent që do të transkrijtojë dhe përkthejë automatikisht mbledhjet dhe seancat e KQZ-së.

Tenderi u publikua më 24 gusht, ndërsa procedura ishte parashikuar të zhvillohej më 24 shtator 2026. Por gjithçka u shty pasi KPP u “bombardua” me ankesa nga kompanitë që mund të kishin planifikuar pjesëmarrjen pasi lexuan kriteret.

Kompanitë “MC Networking” dhe “Dega Semos AI” kanë kërkuar pikërisht në KPP pezullimin dhe ndryshimin e dokumenteve.

“MC Networking” kundërshton veçanërisht detyrimin që ofruesit të demonstrojnë që në ditën e hapjes së ofertave një produkt ekzistues, funksional dhe të përdorshëm, duke përfshirë prototipat dhe versionet e papërfunduara.

Sipas kompanisë, KQZ po kërkon zhvillimin, personalizimin dhe integrimin e sistemit gjatë kontratës, por njëkohësisht kërkon që produkti të jetë gati përpara shpalljes së fituesit.

“Ky kusht asgjëson garën e lirë, duke favorizuar hapur vetëm atë operator që disponon paraprakisht një produkt të tillë specifik për gjuhën shqipe”, thuhet në ankesë.

Akuza është e fortë, aq me tepër që KQZ ka të shkuar të “pasur” të kësaj natyre.

Ankesa tjetër është paraqitur nga “Dega Semos AI”, e cila kundërshton kërkesën për 10 ekspertë, rreth 15 certifikime profesionale dhe nëntë certifikime ISO.

Kompania vëren se një eksperti të vetëm i kërkon certifikimi AWS, certifikimi Microsoft Power BI dhe përvojë në React, megjithëse këto u përkasin roleve të ndryshme profesionale.

“Tërësia e kërkesave... ngushton në mënyrë artificiale konkurrencën në favor të një rrethi tejet të kufizuar operatorësh, ose ndoshta të një operatori të vetëm”, pretendon “Dega Semos AI”.

Kompania ngre edhe shqetësimet për regjistrimet dhe zërat e pjesëmarrësve në seancat e KQZ-së, pasi sipas saj nuk përcaktohet ku do të ruhen të dhënat dhe nëse mund të përdoren nga shërbime të jashtme për trajnimin e modeleve të inteligjencës artificiale.

Pikëpyetjet marrin peshë për shkak të problemeve të dokumentuara në një tender të mëparshëm të KQZ-së për mirëmbajtjen e moduleve ekzistuese, me fond limit rreth 43 milionë lekë.

Në atë procedurë, oferta prej 40.8 milionë lekësh e bashkimit “INTELISOFT” dhe “WOW DIGITAL” u shpall fituese përballë ofertave më të ulëta prej 33 dhe 33.7 milionë lekësh.

Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se në sistemin elektronik kishte ndërhyrë një përdorues që nuk ishte anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Përdoruesi “Jonakqz Josifi” kishte dhënë zero pikë për një ofertë ndërsa pikët maksimale për ofertën e bashkimit ku bënte pjesë kompania e Gëzim Hoxhës, INTELIFOST, një ndër aktorët kryesorë të skandalit AKSHI.

Jona Josifi, në atë kohë Sekretare e Përgjithshme e komanduar, nuk kishte rol formal në vlerësim. Ajo mohoi ndërhyrjen, por KPP evidentoi veprimet e kryera përmes përdoruesit me emrin e saj. Më pas, Josifi u largua nga detyra.

“Çunat” e skandalit DURANA

Një tjetër procedurë që ngre pikëpyetje është tenderi i KQZ-së me objekt “Moduli i Arkivës së Rezultateve Zgjedhore”. Sistemi do të përdoret për ruajtjen, administrimin dhe aksesimin në formë digjitale të rezultateve të zgjedhjeve.

Tenderi kishte fond limit 34.3 milionë lekë, ose rreth 373 mijë euro, ndërsa në garë morën pjesë katër kompani.

“Icom” paraqiti ofertën më të ulët, me 23.2 milionë lekë; “ATOM” oferto 24.9 milionë lekë; “InfoSoft System” 25.8 milionë lekë dhe “Idealdevs Corporation” rreth 34 milionë lekë.

KQZ skualifikoi dy prej kompanive pjesëmarrëse. Njëra ishte “Icom”, e cila sipas dokumenteve u përjashtua për mosgarkimin në sistem të dokumentacionit të kërkuar.

Pas skualifikimeve, “InfoSoft System” u shpall fituese me ofertën 25.8 milionë lekë. Por në garë rezultonte edhe “ATOM”, oferta e së cilës ishte rreth 1 milion lekë më e ulët dhe që, sipas të dhënave të procedurës, nuk figuron e skualifikuar.

Kjo nuk do të thotë automatikisht se tenderi duhej t’i jepej ofertës me çmimin më të ulët, pasi KQZ mund të ketë përdorur edhe kritere teknike dhe sistem pikëzimi. Megjithatë, institucioni duhet të sqarojë se cili element i vlerësimit e bëri ofertën e “InfoSoft System” më të favorshme se ajo e “ATOM”.

“InfoSoft System” është në pronësi të Bledar Dhimes dhe Armand Sharës. Emrat e tyre janë përmendur në raportimet dhe verifikimet që lidhen me “Durana Tech Park”, së bashku me emra të tjerë të sektorit të teknologjisë, përfshirë Ermal Beqirin, Ergys Agasin dhe Gëzim Hoxhën. /skyweb.al

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 29 Shtator09:58

[Arrestohet në Itali i kërkuari Vaxhel Balla, i dënuar për vrasje me paramendim](#)

Policia e Shtetit finalizoi një fazë të re të operacionit të koduar “The Wanted”. Në bashkëpunim me homolog&eu...

AKTUALITET 29 Shtator09:17

[FOTO/ Arrestohet në flagrancë 57-vjeçari, shiste kokainë në lokalin që kishte marrë me qira](#)

Një 57-vjeçar është arrestuar në flagrancë në fshatin Drithas të Maliqit, pasi dyshohet se shiste kokainë n&eu...

AKTUALITET 29 Shtator08:03

[Çfarë po ndodh me monedhat e huaja? Ja sa shitet dhe blihet euro dhe dollari për ditën e sotme](#)

Në tregun e këmbimit valutor shqiptar, një dollar amerikan do të blihet sot me 80.4 lekë dhe do shitet me 81.5 lekë. Ndërk...

AKTUALITET 29 Shtator07:39

[“Ju shoqishojn keni me hangër!”, çfarë u tha komunistëve në gjyq meshtari më 1967! Dy arrestimet e At Pjetër Meshkallës](#)

At Pjetër Meshkalla mbetet një nga figurat më të spikatura të klerit katolik shqiptar dhe një prej dëshmive më të...

AKTUALITET 29 Shtator07:30

[Parashikimi i motit për sot, ja sa do të jenë temperaturat](#)

Vendi ynë do të vijojë të ndikohet nga të njëjtat kushte atmosferike edhe gjatë ditës së martë. Sipas parash...

AKTUALITET 29 Shtator07:13

[Ndalimi i importeve të mishit nga Brazili, përpunuesit paralajmërojnë rritje të çmimeve deri në 40%](#)

Pas ndërprerjeve të importeve nga Brazili, përpunuesit e mishit paralajmërojnë se prej muajit nëntor në tregun vendas prite...

AKTUALITET 28 Shtator22:54

[“O hajdut”, aktivistja i zë pritë Ulsi Manjës pasi del nga Komisioni i Ligjeve](#)

Aktivistja Arvina Lleshi i ka zënë pritë Ulsi Manjës pasi ka dalë nga Komisioni i Ligjeve. “O hajdut” i është dr...

AKTUALITET 28 Shtator22:03

[Shpejtësia me makinën luksoze “tradhton” 29-vjeçarin shqiptar, kapet me mbi 1 kg kokainë](#)

Ajo që e tradhtoi ishte shfaqja e luksit mbi katër rrota. Një makinë supersportive me qindra kuaj fuqi, një Porsche Panamera, që l...

AKTUALITET 28 Shtator21:49

[Konflikt me thikë në një kantier ndërtimi në Greqi, arrestohet 75-vjeçari shqiptar](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e kësaj të hëne në një kantier ndërtimi në rrugën "Gen...

AKTUALITET 28 Shtator 21:21

[Pse mungoi Skënder Hita në takimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare?](#)

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Sigurisë Kombëtare ra në sy mungesa e drejtorit të Përgjithshëm të P...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 28 Shtator

[VIDEO tronditëse/ Oficeri i policisë në pension...](#)

Ali Sekeroğlu kishte bërë thirrje për pjesëmarrje në një demonstratë kundër pensioneve të pamjaftueshme, përme...

BOTA 28 Shtator

[Krimi horror/ Pedagogia 'Satana' copëtoi trupin...](#)

Është Nicole Formichetti, 46 vjeçe, pedagogia që jetonte në apartamentin në rrugën "Tommaso Gulli" në Tori...

AKTUALITET 28 Shtator

["Do të më vrasin bandat"/ Shqiptari fiton të dr...](#)

Një gjyqtar britanik i dha anonimitet një shtetasi shqiptar, i dënuar disa herë për vjedhje dhe që përballlet me dëbimi...

INVESTIGIME 26 Shtator 13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.